



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 70

Tiranë – E enjte, 12 maj 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Ligj nr. 44/2022, datë 28.4.2022	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) (agjencia e zbatimit të projektit) dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për rehabilitimin e hidrocentralit të Fierzës.....	8663
Dekret i Presidentit nr. 13609, datë 10.5.2022	Për shpallje ligji.....	8678
Ligj nr. 45/2022, datë 28.4.2022	Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare”.....	8678
Dekret i Presidentit nr. 13610, datë 10.5.2022	Për shpallje ligji.....	8685
Ligj nr. 47/2022, datë 28.4.2022	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian Horizont Evropa – Programi Kuadër për Kërkimin dhe Inovacionin.....	8685
Dekret i Presidentit nr. 13612, datë 10.5.2022	Për shpallje ligji.....	8697
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 299, datë 11.5.2022	Për miratimin e kontratës së koncesionit/partneritet publik privat, për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e “Portit të integruar” në Triport Vlorë, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “Agbes <i>Construcion</i> ” sh.p.k., “Besta” sh.p.k., “ <i>Premium Construction & Maintenance</i> ” sh.p.k., “ITE Grup” sh.p.k. dhe “Arkonstudio” sh.p.k.	8698
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.5.2022	Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura.....	8698



angazhuar në praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi;

d) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk: i) ka lidhur ndonjë marrëdhënie biznesi me shtetas me emërtim të veçantë apo persona dhe subjekte të bllokuar të renditur në ndonjë lloj liste sanksionesh; ose nuk ii) është angazhuar në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

3.2 Përfaqësimet dhe garancitë e përcaktuara në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato konsiderohen të përsëritura me çdo tërheqje Huaje dhe në çdo datë të pagesës së interesit, duke iu referuar rrethanave mbizotëruese në atë datë.

4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të:

a) përmbushë plotësisht standardet kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në përputhje me rekomandimet e FATF-së dhe të zbatojë, respektojë dhe përmirësojë, nëse është e nevojshme, standardet dhe udhëzimet e brendshme (duke përfshirë pa kufizim, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ndaj klientit), të nevojshme për shmangien e praktikave të sanksionueshme, akteve të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit dhe

b) sapo Agjencia e Zbatimit të Projektit ose KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash apo financim terrorizmi, bashkëpunon plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Agjencia e Zbatimit të Projektit i përgjigjet menjëherë dhe me detaje të arsyeshme çdo njoftimi të KfW-së dhe ofron mbështetje dokumentuese për këtë përgjigje, me kërkesë të KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të:

a) sigurojë se kapitali apo fondet e tjera që investon nuk kanë burim të paligjshëm;

b) sigurojë se biznesi i saj nuk shkakton praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi; dhe

c) mos lidhë apo të mos vijojë asnjë marrëdhënie biznesi me shtetas me emërtim të veçantë, persona ose subjekte të bllokuar, të renditur në ndonjë listë sanksionesh ose të mos angazhohet në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

DEKRET

Nr. 13609, datë 10.5.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 44/2022, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) (agjencia e zbatimit të projektit) dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për rehabilitimin e hidrocentralit të Fierzës”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ

Nr. 45/2022

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EVROPËS “PËR AKSESIN NË DOKUMENTE ZYRTARE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa e Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare”, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Në përputhje me nenin 12, pika 1, të Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare”, Republika e Shqipërisë cakton



Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si përfaqësues në Këshillin e Palëve.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 28.4.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13610, datë 10.5.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

*Këshilli i Evropës
Seria e Traktateve të Këshillit të Evropës nr. 205*

**KONVENTA E KËSHILLIT TË EVROPËS
PËR AKSESIN NË DOKUMENTE ZYRTARE**
Tromsø, 18.VI.2009

Hyrje

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe nënshkruesit e tjerë të kësaj Konvente,

duke pasur parasysh se synimi i Këshillit të Evropës është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të tij, me qëllim mbrojtjen dhe realizimin e idealeve dhe parimeve, të cilat janë trashëgimia e tyre e përbashkët;

duke marrë në konsideratë, në veçanti, nenin 19 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, nenet 6, 8 dhe 10, të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Konventën e Kombeve të Bashkuara për Akses në Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe Akses në Drejtësi në Çështjet Mjedisore (Aarhus, 25 qershor 1998) dhe Konventën për Mbrojtjen e Individëve, në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale të 28 janarit 1981 (ETS nr. 108);

duke marrë gjithashtu në konsideratë Deklaratën e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për lirinë e shprehjes dhe informacionit, të miraturar më 29 prill 1982, si edhe rekomandimet e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare nr. R (81) 19, për aksesin në informacionin që disponohet nga autoritetet publike nr. R (91) 10, për komunikimin te palët e treta të të dhënave personale që

disponohen nga autoritetet publike nr. R (97) 18, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale të mbledhura dhe të përpunuara për qëllime statistikore, nr. R (2000) 13, për një politikë evropiane mbi aksesin në arkiva dhe rek. (2002) 2 për akses në dokumentet zyrtare;

duke pasur parasysh rëndësinë në një shoqëri pluraliste dhe demokratike të transparencës nga ana e autoriteteve publike;

duke pasur parasysh se ushtrimi i të drejtës për akses në dokumentet zyrtare:

i. ofron një burim informacioni për publikun;

ii. ndihmon publikun në formimin e një opinionit për gjendjen e shoqërisë dhe autoritetet publike;

iii. nxit integritetin, efektshmërinë, efikasitetin dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve publike, duke i ndihmuar në këtë mënyrë që të konfirmojnë legjitimitetin e tyre;

si rrjedhojë, duke pasur parasysh se të gjitha dokumentet zyrtare janë, në parim, publike dhe mund të mos bëhen publike vetëm për mbrojtjen e të drejtave të tjera dhe interesave legjitime,

kanë rënë dakord, si më poshtë:

SEKSIONI I

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

1. Parimet e përcaktuara në vijim duhet të konsiderohen të atilla që nuk cenojnë ligje dhe rregullore kombëtare dhe traktate ndërkombëtare, të cilat njohin një të drejtë më të zgjeruar të aksesit në dokumente zyrtare.

2. Për qëllime të kësaj Konvente:

a) i. “autoritete publike” nënkupton:

1. qeveri dhe administratë në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal;

2. organe legjislative dhe autoritete gjyqësore, në masën që kryejnë funksione administrative sipas të drejtës kombëtare;

3. persona fizikë apo juridikë, në masën që ushtrojnë autoritet administrativ;

ii. secila Palë, në momentin e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund të deklarojë se



përkufizimi i “autoriteteve publike” përfshin edhe një apo më shumë nga sa më poshtë:

1. organe legjislative, në lidhje me aktivitete të tyre të tjera;
2. autoritete gjyqësore, në lidhje me aktivitete të tyre të tjera;
3. persona fizikë apo juridikë, në masën që kryejnë funksione publike apo ushtrojnë aktivitetin me fonde publike, sipas të drejtës kombëtare;

b) “dokumente zyrtare” nënkupton çdo informacion të regjistruar në çdo lloj forme, i hartuar apo që është marrë dhe mbahet nga autoritetet publike.

Neni 2

E drejta për akses në dokumente zyrtare

1. Secila Palë duhet të garantojë të drejtën e çdo personi, pa u diskriminuar për ndonjë shkak, për të pasur akses, me kërkesë, në dokumente zyrtare që mbahen nga autoritetet publike.

2. Secila Palë duhet të marrë masat e nevojshme në të drejtën e vet kombëtare, për zbatimin e dispozitave për akses në dokumente zyrtare të përcaktuara në këtë Konventë.

3. Këto masa duhet të merren jo më vonë se në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në lidhje me atë Palë.

Neni 3

Kufizimet e mundshme në aksesin në dokumente zyrtare

1. Secila Palë mund të kufizojë të drejtën e aksesit në dokumente zyrtare. Kufizimet duhet të përcaktohen saktësisht në ligj, të jenë të nevojshme në një shoqëri demokratike dhe proporcionale, me synim mbrojtjen e:

- a) sigurisë kombëtare, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare;
- b) sigurisë publike;
- c) parandalimit, hetimit dhe ndjekjes penale të veprimtarisë kriminale;
- d) hetimeve disiplinore;
- e) inspektimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes nga autoritetet publike;
- f) privatësisë dhe interesave të tjera legjitime private;
- g) interesave tregtare dhe interesave të tjerë ekonomikë;

h) politikave ekonomike, monetare dhe valutore të shtetit;

i) barazisë së palëve në procedimet gjyqësore dhe administrimit të efektshëm të drejtësisë;

j) mjedisit; ose

k) diskutimeve brenda apo ndërmjet autoriteteve publike në lidhje me shqyrtimin e një çështjeje.

Shtetet e interesuara, në momentin e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund të deklarojnë se komunikimi me familjen mbretërore dhe oborrin e saj ose kreun e shtetit, duhet gjithashtu të përfshihet midis kufizimeve të mundshme.

2. Aksesin në informacionin në përmbajtje të një dokumenti zyrtar mund të refuzohet, nëse zbulimi i tij mund ose ka të ngjarë të dëmtojë interesat e përmendura në paragrafin 1, nëse nuk ka një interes publik më të lartë në lidhje me zbulimin e tij.

3. Palët duhet të marrin parasysh caktimin e afateve kohore pas të cilave kufizimet e përmendura në paragrafin 1 nuk zbatohen më.

Neni 4

Kërkesat për akses në dokumente zyrtare

1. Kërkuesi i një dokumenti zyrtar nuk duhet të jetë i detyruar të japë arsye për të pasur akses në dokumentin zyrtar.

2. Palët mund t'i japin kërkuesve të drejtën për të mbetur anonimë, me përjashtim të rastit kur zbulimi i identitetit është thelbësor, me qëllim përpunimin e kërkesës.

3. Procedura administrative që duhet të përmbushet për kërkesat nuk duhet të tejkalojnë atë që është e nevojshme, me qëllim përpunimin e kërkesës.

Neni 5

Përpunimi i kërkesave për akses në dokumente zyrtare

1. Autoriteti publik duhet të ndihmojë kërkuesin, për aq sa është e mundur, që të identifikojë dokumentin e kërkuar zyrtar.

2. Një kërkesë për akses në dokument zyrtar duhet të trajtohet nga çdo autoritet publik që



disponon dokumentin. Nëse autoriteti publik nuk e disponon dokumentin zyrtar të kërkuar ose nëse ai nuk është i autorizuar të përpunojë atë kërkesë, kurdoherë që është e mundur, ai duhet t'ia përcjellë kërkesën ose kërkuuesin autoritetit publik kompetent.

3. Kërkesat për akses në dokumente zyrtare duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë.

4. Kërkesa për akses në një dokument zyrtar duhet të trajtohet menjëherë. Vendimi duhet marrë, komunikuar dhe ekzekutuar sa më shpejt që të jetë e mundur ose brenda një afati kohor të arsyeshëm, i cili është përcaktuar paraprakisht.

5. Një kërkesë për akses në dokumente zyrtare mund të refuzohet:

i. nëse, me gjithë ndihmën nga autoriteti publik, kërkesa nuk është mjaftueshëm e qartë sa të mundësojë identifikimin e dokumentit zyrtar; ose

ii. nëse kërkesa është haptazi e paarsyeshme.

6. Autoriteti publik që refuzon, plotësisht ose pjesërisht, aksesin në një dokument zyrtar duhet të parashtrijë arsyet për refuzimin. Kërkuesi ka të drejtë të marrë, me kërkesë, një arsyetim me shkrim nga ana e autoritetit publik, për shkaqet e refuzimit.

Neni 6

Format e aksesit në dokumente zyrtare

1. Kur jepet akses në një dokument zyrtar, kërkuesi ka të drejtën për të zgjedhur nëse do të shqyrtojë origjinalin apo një kopje të tij, ose për të marrë një kopje të tij në çdo lloj forme të disponueshme ose formati të përzgjedhur nga ai ose ajo, nëse preferenca e shprehur nuk është e paarsyeshme.

2. Nëse në një dokument zyrtar zbatohet kufizim për disa nga informacionet e tij, autoriteti publik sidoqoftë duhet të japë akses në informacionin tjetër që përmban dokumenti. Çdo pjesë e hequr duhet të përcaktohet qartë. Megjithatë, nëse versioni i pjesshëm i dokumentit është i gabuar ose i pakuptimtë, ose nëse përbën një barrë haptazi të paarsyeshme për autoritetin për vënien në dispozicion të pjesës së mbetur të dokumentit, aksesin në të mund të refuzohet.

3. Autoriteti publik mund të japë akses në një dokument zyrtar, duke e referuar kërkuuesin në burime alternative lehtësisht të aksesueshme.

Neni 7

Tarifat për akses në dokumente zyrtare

1. Shqyrtimi i dokumenteve zyrtare në ambientet e një autoriteti publik është pa pagesë. Kjo nuk i pengon Palët të caktojnë tarifa për këto shërbime të ofruara nga arkivat dhe muzetë.

2. Një tarifë mund të caktohet ndaj kërkuetit për një kopje të dokumentit zyrtar, e cila duhet të jetë e arsyeshme dhe të mos tejkalojë kostot aktuale të riprodhimit dhe dorëzimit të dokumentit. Tarifat e pagesave duhet të publikohen.

Neni 8

Procedura e rishikimit

1. Një kërkuet, kërkesa e të cilit për një dokument zyrtar është refuzuar, shprehimisht apo tërthorazi, qoftë pjesërisht apo plotësisht, duhet të ketë akses në një procedurë rishikimi para një gjykate apo organi tjetër të pavarur dhe të paanshëm të krijuar me ligj.

2. Një kërkuet duhet të ketë gjithmonë akses në një procedurë të shpejtë dhe jo të kushtueshme rishikimi që përfshin qoftë një rishqyrtim nga një autoritet publik ose rishikim në përputhje me paragrafin 1.

Neni 9

Masat plotësuese

Palët duhet të informojnë publikun për të drejtën e tij për akses në dokumente zyrtare dhe mënyrën sesi mund të ushtrohet ajo e drejtë. Gjithashtu, ato duhet të marrin masat e përshtatshme për:

a) të edukuar autoritetet publike mbi detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me zbatimin e kësaj të drejte;

b) të dhënë informacion mbi çështjet ose aktivitetet për të cilat janë përgjegjëse;

c) të menaxhuar dokumentet e tyre me efikasitet, në mënyrë që të jenë lehtësisht të aksesueshme; dhe

d) të zbatuar rregulla të qarta dhe të përcaktuara për ruajtjen dhe shkatërrimin e dokumenteve të tyre.



Neni 10

Dokumentet e bëra publike me nismën e autoriteteve publike

Një autoritet publik, me nismën e vet dhe kur është e nevojshme, duhet të marrë masat e nevojshme për të bërë publike dokumentet zyrtare që ai disponon, në interes të nxitjes së transparencës dhe efektshmërisë së administratës publike dhe inkurajimit të pjesëmarrjes së informuar nga ana e publikut për çështje me interes të përgjithshëm.

SEKSIONI II

Neni 11

Grupi i Specialistëve për Akses në Dokumentet Zyrtare

1. Një Grup Specialistësh për Akses në Dokumente Zyrtare duhet të zhvillojë takime, të paktën një herë në vit, me synim monitorimin e zbatimit të kësaj Konvente nga Palët, veçanërisht:

a) për të raportuar mbi mjaftueshmërinë e masave të marra nga Palët, sipas ligjit dhe në praktikë, me synim zbatimin e dispozitave të përcaktuara në këtë Konventë;

b) i. për të shprehur opinione për çdo çështje që lidhet me zbatimin e kësaj Konvente;

ii. për të bërë propozime për lehtësimin ose përmirësimin e përdorimit të efektshëm dhe zbatimin e kësaj Konvente, duke përfshirë identifikimin e problemeve;

iii. për të shkëmbyer informacion dhe raportuar mbi zhvillimet e rëndësishme ligjore të politikave ose teknologjike;

iv. për të bërë propozime te Këshilli i Palëve për amendimin e kësaj Konvente;

v. për të formuluar opinionin e tij, në lidhje me çdo propozim për amendimin e kësaj Konvente, të bërë në përputhje me nenin 19.

2. Grupi i Specialistëve mund të kërkojë informacion dhe opinione nga shoqëria civile.

3. Grupi i Specialistëve përbëhet nga të paktën 10 dhe maksimumi 15 anëtarë. Anëtarët zgjidhen nga Këshilli i Palëve për një afat prej katër vitesh, me të drejtë të vetëm një rizgjedhjeje, nga një listë ekspertësh, ku secila Palë propozon dy ekspertë. Ata duhet të përzgjidhen prej personave me integritetin më të lartë, të njohur për kompetencën

e tyre në fushën e aksesit në dokumente zyrtare. Vetëm maksimumi një anëtar mund të zgjidhet nga lista e propozuar nga secila Palë.

4. Anëtarët e Grupit të Specialistëve duhet të mblidhen në cilësinë e tyre individuale, të jenë të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin e funksioneve të tyre dhe nuk duhet të marrin udhëzime nga qeveritë.

5. Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Grupit të Specialistëve përcaktohet nga Komiteti i Ministrave, pas konsultimit me të dhe pas marrjes së miratimit unanim të Palëve të Konventës, brenda një periudhe një vjeçare nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente. Grupi i Specialistëve duhet të miratojë rregullat e veta të procedurës.

Neni 12

Këshilli i Palëve

1. Këshilli i Palëve përbëhet nga një përfaqësues të secilës Palë.

2. Këshilli i Palëve duhet të zhvillohet me qëllim që:

a) të shqyrtojë raportet, opinionet dhe propozimet e Grupit të Specialistëve;

b) të paraqesë propozime dhe rekomandime tek Palët;

c) të bëjë propozime për amendimin e kësaj Konvente, në përputhje me nenin 19;

d) të formulojë opinionin e vet në lidhje me çdo propozim për amendim të kësaj Konvente, të bërë në përputhje me nenin 19.

3. Këshilli i Palëve duhet të mblidhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës brenda një viti nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente, me qëllim zgjedhjen e anëtarëve të Grupit të Specialistëve. Në vijim, ai duhet të mblidhet të paktën një herë çdo 4 vjet dhe në çdo rast, kur shumica e Palëve, Komiteti i Ministrave ose Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës kërkon mbledhjen e tij. Këshilli i Palëve duhet të miratojë rregullat e veta të procedurës.

4. Pas çdo mbledhjeje, Këshilli i Palëve duhet t'i paraqesë Komitetit të Ministrave raportin e aktivitetit.



Neni 13 Sekretariati

Këshilli i Palëve dhe Grupi i Specialistëve asistohet nga Sekretariati i Këshillit të Evropës për përmbushjen e funksioneve të tyre, në zbatim të këtij seksioni.

Neni 14 Raportimi

1. Brenda një periudhe njëvjeçare nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente, për sa i takon një Pale Kontraktuese, kjo e fundit duhet t'i transmetojë Grupit të Specialistëve një raport që përmban informacion të plotë për masat legjislative dhe masa të tjera të ndërmarra për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente.

2. Në vijim, secila Palë duhet t'i transmetojë Grupit të Specialistëve, përpara çdo mbledhjeje të Këshillit të Palëve, një përditësim të informacionit të përmendur në paragrafin 1.

3. Gjithashtu, secila Palë i transmeton Grupit të Specialistëve çdo informacion që ai kërkon, për përmbushjen e detyrave të tij.

Neni 15 Publikimi

Raportet e paraqitura nga Palët tek Grupi i Specialistëve, raportet, propozimet dhe opinionet e Grupit të Specialistëve dhe raportet e aktivitetit të Këshillit të Palëve duhet të bëhen publike.

SEKSIONI III

Neni 16 Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi e Konventës

1. Kjo Konventë duhet të jetë e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit apo miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit apo miratimit duhet të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

3. Kjo Konventë duhet të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të periudhës prej tre muajsh, pas datës në të cilën 10 shtete anëtare të Këshillit të Evropës kanë shprehur miratimin e tyre

që kjo Konventë të jetë e detyrueshme për ta, në përputhje me dispozitat e paragrafit 2.

4. Për sa i takon çdo shteti nënshkrues, i cili shpreh më pas miratimin e tij që Konventa të jetë e detyrueshme për të, ajo do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të një periudhe prej tre muajsh, pas datës së shprehjes së miratimit që Konventa të jetë e detyrueshme për të, në përputhje me dispozitat e paragrafit 2.

Neni 17 Aderimi në Konventë

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës mund të ftojë çdo shtet që nuk është anëtar i Këshillit të Evropës apo çdo organizatë ndërkombëtare që të aderohet në këtë Konventë, pas konsultimit me Palët e Konventës dhe marrjes së pëlqimit të tyre unanim. Vendimi merret nga shumica e parashikuar në nenin 20 “d” të Statutit të Këshillit të Evropës dhe me votë unanime të përfaqësuesve të Palëve anëtare të Komitetit të Ministrave.

2. Për sa i takon çdo shtet apo organizatë ndërkombëtare që aderon në këtë Konventë, sipas paragrafit 1 të mësipërm, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të periudhës prej tre muajsh, pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

Neni 18 Zbatimi territorial

1. Çdo shtet, në momentin e nënshkrimit apo depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, mund të përcaktojë territorin apo territoret në të cilat do të zbatohet Konventa.

2. Çdo shtet, në ndonjë datë të mëvonshme, me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të përcaktuar në deklaratë, për marrëdhëniet ndërkombëtare të së cilit është përgjegjës. Për sa i takon këtij territori, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të periudhës prej tre muajsh, pas datës së marrjes së kësaj deklaratë nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.



3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm, në lidhje me çdo territor të përcaktuar në këtë deklaratë, mund të tërhiqet me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të periudhës prej tre muajsh pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 19

Amendimet e Konventës

1. Amendimet e kësaj Konvente mund të propozohen nga çdo Palë, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, Grupi i Specialistëve ose Këshilli i Palëve.

2. Çdo propozim për amendim i komunikohet Palëve nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.

3. Çdo amendim i komunikohet Këshillit të Palëve, i cili, pas konsultimit me Grupin e Specialistëve, duhet t'i paraqesë Komitetit të Ministrave opinionin e tij për amendimin e propozuar.

4. Komiteti i Ministrave shqyrton amendimin e propozuar dhe çdo opinion të paraqitur nga Këshilli i Palëve dhe mund të miratojë amendimin.

5. Teksti i çdo amendimi të miratuar nga Komiteti i Ministrave, në përputhje me paragrafin 4, duhet t'i përcillet Palëve për pranim.

6. Çdo amendim i miratuar në përputhje me paragrafin 4 duhet të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të periudhës prej një muaji, pas datës kur të gjitha Palët kanë informuar Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin nga ana e tyre.

Neni 20

Deklaratat

Secila Palë, në momentin e nënshkrimit apo depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, mund të bëjë një apo më shumë deklarata të parashikuara në nenet 1.2, 3.1 dhe 18. Ajo duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për çdo ndryshim të këtij informacioni.

Neni 21

Tërheqja

1. Secila Palë mund të tërhiqet nga kjo Konventë në çdo kohë, me anë të një njoftimi të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

2. Tërheqja do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të periudhës prej gjashtë muajsh, pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 22

Njoftimi

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës duhet të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe çdo shtet dhe organizatë ndërkombëtare që ka aderuar apo është ftuar të aderohet në këtë Konventë, në lidhje me:

- a) çdo nënshkrim;
- b) depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në përputhje me nenet 16 dhe 17;
- d) çdo deklaratë të bërë sipas neneve 1.2, 3.1 dhe 18;
- d) çdo akt, njoftim ose komunikim në lidhje me këtë Konventë.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar sipas rregullave për këtë, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Tromsø, në datën 18 qershor 2009, në gjuhët angleze dhe frënge, të dyja tekstet e të cilave janë njëllorj autentike, në një kopje të vetme që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t'i transmetojë kopje të vërtetuara secilit shtet anëtar të Këshillit të Evropës dhe secilit shtet dhe organizatë ndërkombëtare të ftuar për të aderuar në këtë Konventë.



DEKRET
Nr. 13610, datë 10.5.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 45/2022, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës ‘Për aksesin në dokumente zyrtare’”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta